



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr 50 prot.

Kamëz, më 25. 5.2026

V E N D I M
Nr. 43 .Datë 25.5 2026
MBI

“MIRATIMIN E DHËNIES SË NDIHMËS FINANCIARE, BONUSIN E QIRASË PËR Z.
”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 25.05.2026, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.30 Datë 19.05.2026 në mbështetje të Kushtetutës, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social” i ndryshuar; Ligji, Nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”; Vendimit nr. 301, datë 15.04.2020, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit”, Vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM nr.362 date 20.05.2019 “Për kriteret e dhënies subvencionimit qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”; VKM-së Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”; Vendimit nr.80 datë 20.11.2025 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e manualit të subvencionimit të qirasë në Bashkinë Kamëz për familjet që nuk mund të përballojnë pagesën e qirasë ”; VKB nr 90 dt.17.12.2025 për “Miratimin e detajimit të buxhetit të vitit 2026, 2027, 2028”; **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Miratimin e trajtimit me subvencion të qirasë për z. _____ sipas listës bashkëlidhur dhe relacionit pjesë përbërëse e këtij vendimi me vlerë **18.000 (tetëmbëdhjetë mijë) Lekë** në muaj.
- 2 Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për familjen e përcaktuar në pikën 1 do të jetë duke filluar nga data 01.06.2026 deri në datën 31.12.2026.
- 3 Kjo shumë do të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Kamëz, struktura buxhetore: Gr.0, Kap.05, Progr. 03280, Art. 606.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtorinë e Emergjencave Civile dhe Strehimit.

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI